

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

DUKURIA E EKSTREMIZMIT DHE TERRORIZMIT



**EXTREMISM &
TERRORISM**

Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

DUKURIA E EKSTREMIZMIT

**(TRAJTIMI I SAJ NDËRMJET PËRPJËKJEVE DIPLOMATIKE, AJETEVE
KUR'ANORE DHE THËNIEVE PROFETIKE)**

PERKTHEU DHE PERSHTATI NE SHQIP

SEDAT ISLAMI

REDAKTOR GJUHEJOR : SEDAT ISLAMI

RECEZENTE : DOC.DR.HFZ.HAJREDIN HOXHA

Hyrje në botën e terrorizmit dhe tiparet e terroristëve

(diagnostikimi i sëmundjes)

Të gjitha falënderimet dhe lavdatat i takojnë Allahun xh.sh. Salavatët tona, lutjet tona qofshin për krijesën më të bukur dhe zotëriun e peygamberëve Muhamedin a.s., familjen e tij, shokëve të tij dhe për të gjithë ata të cilët e ndjekin rrugën e tij deri në momentin e fundit të kësaj jete.

Thotë Allahu në Kur'anin fisnik:

***“Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush, (por edhe të mirët), dhe ta dini se All-llahu është ndëshkues i rreptë“.*¹**

***“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat)“.*²**

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun. E sikur ithtarët e librit të beso-

¹ el-Enfale, 25.

² err-Rrum, 41.

nin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit“.³

Bazuar në këto dhe në tekste të tjera kur'anore, ne obligohemi të urdhërojmë për të mirë dhe të ndalojmë nga e keqja, ta pengojmë tiranin dhe mëkatarin nga dhuna dhe mëkatet. Sepse, përndryshe, Allahu, për shkak të disa njerëzve të paktë që luajnë me sigurinë e njerëzve dhe bëjnë shkatërrime në tokë, do të na ndëshkojë të gjithë, ngase ndëshkimi i Allahut sikur nuk shtyhet, po ashtu as nuk dallon të mirin nga i keqi, myslimanin nga jomyslimani; ai i përfshin të gjithë...

Sot, ymeti islam sa vuan nga armiqtë e jashtëm, të cilët i janë vërsulur për t'ia thithur gjakun, për t'i grabitur pasurinë, për të shkaktuar dyshime në besim e fe, duke u ndihmuar edhe nga globalizmi dhe shekullarizmi, dhe kjo nëpërmjet mjeteve të informimit, të shkruara apo elektronike qofshin, me pretekst të përhapjes së të “mirës“, kulturës, civilizimit, globalizmit dhe demokracisë, - ai po aq, në mos më shumë, vuan edhe nga plasaritjet e brendshme të strukturës së tij. Divergjencë në të menduar e të besuar, ndarje në lëvizje, grupe, medh'hebe e parti, mbytje dhe dëbim nga shtëpitë të njerëzve të pafajshëm dhe të shtyrë në moshë, pleq, gra apo fëmijë të jenë ata...Të gjitha këto janë pjellë fatzezë e kësaj divergjence, përçarjeje dhe fatkeqësie fetare e njerëzore që ka sulmuar rëndë Botën Islame.

³ Ali Imran, 110.

Në disa vende të Botës Arabe dhe Islame janë shfaqur disa të rinj myslimanë, të cilët bëjnë thirrje për rikthimin në Islam. *“Xhihad, Xhihad!”, “Vdekje kolaboracionistëve dhe hipokritëve”,* janë moto të tyre.

Po të analizojmë dhe të shtjellojmë çështjen e tyre, do të shohim se ata janë bartës të ideve të prapambetura dhe ekstreme. Ata prej Islamit hise kanë vetëm emrin e tij, sa kohë që kundërshtojnë udhëzimet e tij. Ata shkaktojnë trazira, rrëmuja, kaos dhe skandale në tok, po mendojnë se janë duke vepruar drejt. Tronditin dhe trazojnë thellë qetësinë shpirtërore, ideore dhe politike të myslimanëve. Bëjnë thirrje për të mos respektuar prijësit, kundërshtimin dhe kryengritjet ndaj tyre, dhe jo vetëm kaq, ata edhe nxisin rininë që, krahas kësaj kryengritjeje, të luftojnë edhe të gjithë ata që gjenden përkrah këtyre liderëve, pa marrë parasysh se a janë dijetarë, persona të organit të sigurisë, etj.

Fatkeqësisht, e tërë kjo marrëzi kryhet në emër të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja e përhapjes së të mirës dhe luftimit-pengimit të së keqes. Predikojnë dashurinë për vlera e virtyte, për mirëkuptim në mes njerëzve, kurse realiteti i tyre dëshmon të kundërtën. Ata rrokën armët për të luftuar të gjithë ata që nuk ndajnë mendim të njëjtë me të tyre dhe nuk besojnë sikurse besimi-bindja e tyre. Shembulli i fjalëve të tyre është sikurse shembulli i Faraonit, i cili u tha izraelitëve:

...Faraoni tha: "Unë nuk kam mendim tjetër t'ju jap përveç atij që ju thashë, dhe nuk jam duke ju udhëzuar tjetër përveçse në rrugën e drejtë!"⁴

Ne, duke studiuar tekstet kur'anore dhe ato profetike, me lejen e Allahut, do të arrijmë tek rrënjët e këtij problemi shoqëror dhe fetar. Do të njihemi edhe me ligjet e Allahut nën kupolën e këtij kozmosi dhe me mënyrën e ndërrimit dhe largimit të së keqes. Do të bindemi se rekomandimet kur'anore janë shërimi më adekuat!

Ky studim do të diagnostikojë këtë sëmundje duke u nisur nga parimi bazë se terrorizmi, para së gjithash, është një sëmundje ideologjike, dogmatike dhe origjinale, që i ka rrënjët e tij ideologjike, dogmatike (fetare) dhe historike. Patjetër, pra, me ata ekstremistë e terroristë, na duhet të hyjmë në një betejë ideore dhe civilizuese-kulturore, që t'i mundim ata, sepse trajtimi-shërimi i idesë së gabuar dhe kulturës së shtrembëruar nuk bëhet veçse nëpërmjet idesë së qëlluar dhe origjinale, e cila mbështetet në Kuran e Synet, në përpjekje shkencore të dijetarëve, të shquar për devotshmëri dhe sinqeritet, në të kaluarën dhe të tashmen.

Ky punim, dashtë Allahu, do të jete si përgjigje e çështjeve vijuese:

Domethënia e Terrorizmit dhe rrënjët e ideologjike dhe historike të kësaj dukurie.

⁴ Gafir, 29.

Cila është rruga ideore dhe cilat janë hapat metodikë që ndihmojnë në zhdukjen e dukurisë së terrorizmit?

A është zgjidhje për këtë fatkeqësi ideologjike, fetare dhe shoqërore mbështetja për idenë e matur (meshtarisë) dhe balancimit-ekuilibrit në dritën e Kur'anit dhe Syneetit?

-I-

Domethënia e Terrorizmit

Historikisht, bazuar në disa studime bashkëkohore, fjala terrorizëm është përdorur për një lloj pushteti të përvetësuar nga Revolucion i Frëng në periudhën e Republikës së Jakobinëve (Jacobin Republic) në vitet 1793-1794 kundër paktit të dy mbretërve borgjezë, që ishin kundër revolucionit. Si rezultat i terrorizmit të asaj periudhe, e cila quhet *“Reign of Terror”* (Epoka e terrorit), u arrestuan 300.000 të dyshimtë dhe u ekzekutuan afër 17.000 të tjerë, duke mos llogaritur këtu mijëra të burgosur që vdiqën nëpër burgje.

Sipas disa studiuesve, terrorizmi kishte ndodhur shumë më herët, madje gjatë gjithë historisë njerëzore, madje në të gjitha anët e botës. Historiani grek, Ksenefon (Xenophon, 30-34 para Isait) kishte shkruar për nxitjet shpirtërore për luftë dhe terror ndaj popujve. Ai kishte folur për pushtetarë romakë, si: Tiberius (14-37 p. I.), Caligula (37-41 p. I.), të cilët me anë të dhunës, konfiskimit të pasurisë dhe ekzekutimit, kishin nënshtruar ata që kundërshtonin pushtetin e tyre. Ndoshta inkuizicioni që bënte spanjollët ndaj pakicave fetare, dhe sidomos ndaj asaj myslimane, ishte prej stacioneve më të rëndësishme të terrorizmit në historinë e kulturës perëndimore.

Disa shtete terrorizmin e kishin përvetësuar si pjesë të strategjisë politike të shtetit, si: Hitleri nazist në Gjermani dhe Stalini në ish-Bashkimin Sovjetik. Nga këndvështrimi perëndimor, organizata dhe lëvizje, si: Bader Majenhof në Gjermani, ushtria e kuqe japoneze, ushtria republikane irlandeze, “Eta” baske etj., janë llogaritur ndër organizatat më të njohura të terrorizimit në historinë e shekullit XX.

Po ta analizojmë domethënien e kësaj fjale në gjuhën arabe nga aspekti i përbërjes së saj gramatikore dhe morfologjike, do të shohim se fjala “Irhab” (إِرْهَاب) rrjedh nga folja “Erhebe” (أَرْهَبَ), që ka kuptimin e frikësimit. Thuhet: “Erhebe fulanen”- e ka frikësuar filanin. Kuptim të ngjashëm ka edhe fjala: “Rehhebe” (رَهَّبَ). Ndërsa folja “Rehibe” (يَرْهَبُ رَهْبَةً وَرَهَبًا) ka kuptimin e frikës. Thuhet “Rehibe’sh shej’e rehben”- ia ka frikën diçkaje. Folja “Terehhebe” (تَرَهَّبَ) ka kuptim të vetmimit në sinagogë për adhurim. Prej kësaj fjale rrjedh fjala rabin (ar. rahib, rahibe, ruhbanijeh). Kjo folje, nëse është kalimtare, përdoret edhe me kuptim të kërcënimit. Kur’ani këtë shprehje e ka përdorur edhe në formën “Isterhebe” me kuptim të foljes “Rehhebe”, në tregimin e Faraonit me magjistarët e vet dhe Musain alejhi’s selam:

“Ai (Musai) tha: "Hidhni ju"! E kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe”.⁵

⁵ el-A’rafe, 116.

Siç po vërejmë, Kur’ani fjalën terrorizëm (Irhab) nuk e ka përdorur vetëm në këtë formë, por e përdori në forma të ndryshme, të cilat rrjedhin prej kësaj materieje, disa prej të cilave tregojnë për terrorizëm, frikë, lemeri, druajtje, ankth e kërcënim, kurse të tjerat aludojnë adhurimin dhe lutjen. Kjo fjalë me derivatet e saja me kuptim të “frikës dhe trembjes“, në Kuran është përdorur 7 herë në vende të ndryshme: (Jerhebune يَرْهَبُونَ)⁶, (Ferhebun فَارْهَبُونَ)⁷, (Turhibune تُرْهَبُونَ)⁸, (Isterhebumم استرهبواهم)⁹, (Rehbeten رَهْبَةً)¹⁰, (Reheben رَهَبًا)¹¹.

E me kuptim të “adhurimit dhe lutjes“ është përdorur pesë herë në vende të ndryshme: (err-Ruhban الرهبان)¹², (Ruhbanen رهباناً)¹³, (Ruhbanehum رهبانهم)¹⁴, (Rehbanijjeten رهبانية)¹⁵.

Derivatet e fjalës “Rehebe” (رَهَبَ) nuk janë përmendur shpesh në hadithe të Muhamedit, alejhi’s selam. Ndoshta prej më të njohurave është shprehja “Rehbeten” (رَهْبَةً), në duanë:

“Të lus me dëshirë (për shpërblimin Tënd) e frikë (nga ndëshkimi Yt) tek Ti”.¹⁶

Një gjë që vërehet qartë, është edhe kjo që Kur’ani dhe Syneti përmbajnë disa fjalë që në vete kanë kuptime të terrorizmit dhe dhunës, ose, thënë me fjalë të tjera, përdorimit të forcës dhe kër-

⁶ el-A’rafe, 154.

⁷ el-Bekare, 40.

⁸ el-Enfale, 60.

⁹ el-A’rafe, 116.

¹⁰ el-Hashr, 13.

¹¹ el-Enbija, 90.

¹² et-Teube, 34.

¹³ el-Maide, 82.

¹⁴ et-Teube, 31.

¹⁵ el-Hadid, 27.

¹⁶ Hadithi është autentik. Shih: Sahihu’l kelimi’t tajjibi, 26/41. Shënim i përkthyesit.

cënimit për realizimin e disa synimeve të caktuara. Prej këtyre domethënieve janë: ndëshkimi, mbytja, padrejtësia, armiqësia, xhihadi, lufta, etj, veçse këto fjalë kanë domethënie të caktuar, që dalin nga konteksti i ajetit a hadithit.

-II-

Sfondi historik i dukurisë së terrorizmit

Kohët e fundit është shfaqur një dukuri e re nga forma e ngjyra, por e vjetër nga rrënjët dhe ekzistenca. Sipas studimeve flitet se rastet më të vjetra të njohura si terroriste, janë regjistruar nga një sekt fetar çifut, Sikariunët, një sekt ekstrem, që për të sulmuar armiqtë, përdorte taktika të panjohura. Zakonisht preferonin sulmin gjatë ditëve festash....

Mendohet se kjo dukuri ishte regjistruar pas zbulimit të kontinentit amerikan, në fund të shek. XV,. Shoqëria amerikane ishte e ndërtuar mbi baza racore, burim i të cilave ishte ideja fetare çifute, e cila kishte depërtuar nëpërmjet puritanëve britanezë. Bazuar në këtë bazë historike fetare çifute, mbi të cilën ishte themeluar Amerika Veriore, amerikanët e panë veten si misionarë të mesazhit fetar botëror dhe sikur ata ishin Izraeli i ri, që Allahu i zgjodhi për ta luajtur këtë rol të udhëheqësit të botës...

Edhe pse kështu thuhet për zanafillën e kësaj dukurie, megjithatë, gjatë shtjellimit dhe analizave të ndryshme, vijmë në përfundimin se kjo dukuri shtrihet shumë larg përtej këtyre kufijve kohorë që u përmendën më lart. Zanafilla e saj buron nga konflikti i bijve të Ademit, alejhi's selam, njeriut të parë në tokë. Thotë Allahu:

“Lexoju (Muhammed) atyre (jehudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbanë, nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: "Unë do të të mbys ty" (Kabili i tha Habilit). E ai (që iu pranua) tha: "All-llahu pranon vetëm prej të sinqertëve“.¹⁷

Pastaj këtë dukuri e trashëguan çifutët dhe të krishterët, të cilët vranë e masakruan profetë e të dërguar të Allahut. Kur’ani i ka regjistruar këto vepra të ndyra të këtyre njerëzve, të cilët i mbytnë peygamberët pa asnjë të drejtë. Thotë Allahu:

“Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni atë që shpalli All-llahu", ata thonë: "Ne besojmë atë që na u shpall neve", kurse e mohojmë atë pas tij, edhe pse është vërtetues i atij që e kanë ata dhe është i vërtetë. Thuaj: "Nëse jeni besimtarë, pse pra i mbytnit më parë peygamberët e All-llahut"?“.¹⁸

Edhe përkitazi me historinë islame janë shënuar incidente apo akte të tilla terroriste. Qysh prej fillimit të shkëndijave të para të fesë islame, predikuesi i saj, Muhamedi, alejhi’s selam, dhe shoqët e tij, u ishin ekspozuar terrorizmit, mundimit, persekutimit, maltretimit, që shkaktuan edhe migrimin e tyre dy herë në Etiopi dhe, së fundi, edhe në Medinë. Pastaj bllokada ekonomike dhe shoqërore për Hashimitët; komploti i organizuar kundër Muhamedit, alejhi’s selam, pak para hixhretit; për të vazhduar pas hixhretit me luftëra e beteja të mëdha, - janë dëshmi për këtë

¹⁷ el-Maide, 27.

¹⁸ el-Bekare, 91.

terror të dhunshëm. Kurse skenat e këtij terrori pas vdekjes së Muhamedit, alejhi's selam, nuk ditën të pushonin.

-III-

Islami është i pastërnga akuzat për terrorizëm

Islami nuk ka asnjë lidhje me terrorizmin. Ai qëndron shumë larg terrorizmit dhe dhunës së ushtruar nga bindje personale të kujtqo qofshin. Ndërsa, për sa u përket orientalistëve dhe perëndimorëve, ata përkitazi me këtë çështje, siç e kanë zakon, në studimet e tyre që ua dedikojnë idhujve të tyre (liderëve të tyre), dolën me rezultate të marra. Ata Islamin e karakterizuan si: *Islam politik, Islam progresiv, Islam popullor, Islam tradicional, Islam i ringjallur-i ripërtërirë, Rizgjim islam, Islam fundamental, Islam revolucionar, Islam radikal, Islam të ashpër, Islam militant, Dhunë islame, dhe, së fundi, Islam terrorist.*

Demantimin tonë për këtë shpifje dhe akuzë të pabazë, do të mund ta përmbledhim në këto pika:

Vetë rregullat fetare, që disa nga dijetarët tanë të sinqertë, i nxorën nga tekstet uranore, demantojnë një gjë të tillë. “*Nuk ka dëm e as dëm reciprok*“ (ose thënë me fjalë të tjera, nuk bën ta dëmtosh askënd dhe as dëmin e shkaktuar nga dikush ta kthesh me dëm); “*Dëmi largohet aq sa të kemi mundësi*“; “*Dëmi nuk largohet me një dëm si ai apo më i madh se ai*“; “*Përballohet dëmi i vogël që t’i iket dëmit të madh*“, etj. - janë disa prej këtyre rregullave fetare.

Ndërsa nga tekstet fetare që Islamin e zhveshin dhe shfajësojnë nga akuzat e tilla, do të përmendnim:

“Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni-Israilëve se kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë), është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit. Atyre (ben-Israilëve) u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij (vendimi) shumë prej tyre e teprojnë (kalojnë kufijtë në mbytje) në këtë tokë“.¹⁹

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu në All-llahun. Ai është që dëgjon dhe di“.²⁰

Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vetë, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse kthehet, atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, mbani drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtët“.²¹

Ndërsa nga tekstet profetike do të zgjidhnim hadithin:

Ai që kundërshton (udhëheqësin) dhe ndahet nga kolektivi e vdes (në këtë gjendje), vdekja e tij është sikurse e injorantëve. Kush lufton dhe nuk di se për se lufton (ose lufton për fanati-

¹⁹ el-Maide, 32.

²⁰ el-Enfale, 61.

²¹ el-Huxhurat, 9.

zëm²² ose luftojnë në kuadër të një grupi që nuk dihet se lufta e tyre bëhet apo jo për Allahun²³), hidhërohet për fanatizëm ose fton në fanatizëm ose përkrah ndonjë të afërm a farefis (nga këndvështrimi i tij fanatik) dhe mbytet, mbytja e tij është sikur e injorantëve. Kush ngrihet nga umetit im dhe sulmon të mirin e të keqin dhe aspak nuk i intereson fati i të mirit (të pafajshmit) si dhe nuk i përmbahet besës për atë që ka besë, ai as nuk është prej meje, po as unë nuk jam prej tij“.

Ebu Davudi transmeton se Muhammedi, alejhi's selam, ka thënë:

*"Nuk lejohet që myslimani të frikësojë myslimanin“.*²⁴

Bazuar në këto tekste fetare, çdo dëm, qoftë ai shqisor apo kuptimor, që godet individët apo shoqëritë e pastra-të pafajshme, siç është sot dëmi nga dukuria e terrorizmit, është prej veprave të urryera dhe të refuzuara, dhe është e ndaluar-haram. Për sfidim të kësaj gare-sfide të mbrapsht ideore dhe fetare, Kur'ani na fton t'i përmbahemi metodës së tij. Feja jonë është fe e paqes dhe sigurisë, e jetës dhe kulturës, fe që ruan interesin e robërve në këtë botë dhe në botën tjetër. Ajo nuk është fe e vdekjes, mbytjes, shkatërrimit, frikës, siç mendojnë ata që nuk kanë fat aspak në dituri. Mbi të gjitha, Islami është fe që ruan gjërat më të shenjta njerëzore, pa të cilat jeta nuk do të kishte kuptim. Cenimin i tyre, sa kohë që Islami i cilësoi si të

²² Imam Neveviu ka përmendur në kuptim të kësaj fjale dy domethënie: Nuk di se për çka lufton, dhe lufton për fanatizëm. Përkthyesi.

²³ Sherhu suneni'n Nesaijj. Përkthyesi.

²⁴ Transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij ndërsa Albani ne Sahihu ve daifu suneni Ebi Davud, 5004, e ka cilësuar si autentik. Përkthyesi.

shenjta, e ka ndaluar. Ato gjëra janë: Feja, shpirti (njeriu), mendja, nderi dhe pasuria.

IV

Tiparet e ekstremizmit dhe format e tij

Prej formave të ekstremizmit dhe vrazhdësisë së pashpirt, mendimtarët dhe dijetarët kanë veçuar:

1. Ekstremizmi në të menduar, duke mos pranuar mendim tjetër për gjëra që janë lëndë shkencore dhe mund të përmbajnë kuptime të ndryshme. Mendim përveç mendimit të vet nuk ekziston...
2. Obligimi me disa gjëra të mundimshme, të cilat Allahu nuk ua ka obliguar krijesave të Tij. Kjo, që në fillim, bie ndesh me fjalën e Muhamedit, alejhi's selam:
Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos largoni (njerëz shkaku i sjelljeve tuaja të këqija)".²⁵
3. Prej formave të këtij lloji është edhe llogaritja për gjëra sekondare sikur ato të ishin primare, dhe për gjëra të urryera - si të ishin të ndaluara.
4. Rigoroziteti dhe mënyra strikte në vend jo të duhur. Më konkretisht, me njerëz që sapo kanë hyrë në Islam apo janë në ndonjë vend joislam, sillet sikur të diskutonte me ndonjë mysliman që ka lindur i tillë apo ka jetuar në një vend islam që prej vegjëlisë. Me njerëzit e grupit të parë duhet përdorur më-

²⁵ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

nyra e lehtësimit në çështjet sekondare dhe të diskutueshme tek dijetarët.

5. Vrazhdësia dhe ngurtësia shpirtërore. Këto gjëra janë në kundërshtim me Urdhrat dhe Porositë e Allahut dhe të dërguarit të Tij.
6. Supozimet dhe paragjykimet për njerëz. Parim bazë tek ekstremistët është akuza, kurse në ligje e norma *“I akuzuari është i pafajshëm derisa të mos e vërtetojnë të kundërtën provat dhe dëshmitë”*.
7. Imagjinim i gabuar i shoqërisë ku jetojnë. Ata mendojnë se shoqëria islame duhet të jetë shoqëri engjëjllore, e cila udhëhiqet nga dashuria, mirëkuptimi dhe respekti i përhershëm, që nuk lë vend kurrë për lëshime. Nëse shoqëria është e tillë, ajo është islame, përndryshe ajo është injorante dhe joislame. Ky mendim, edhe pse i dëshiruar nga të gjithë ne, megjithatë nuk është real, ngase nuk ka njeri që nuk gabon dhe imagjinimi i një shoqërie pa gabime është vetëm iluzion. Çdo njeri gabon dhe nuk është përmendur që ndonjë popull të mos ketë pasur gabime, sikurse nuk është transmetuar se ndonjë peygamber t’i ketë pasur pasuesit qind për qind të pastër nga mëkatet.
8. Rënia në humnerën e tekfirit. Ky ekstremizëm arrin kulmin e vet atëherë kur njerëzit i zhvesh nga identiteti i tyre islam dhe lejon derdhjen e gjakut të tyre dhe konfiskimin e pasurive të tyre.

V

Shkaqet dhe motivet e ekstremizmit

Shkaqet dhe motivet e ekstremizmit, siç i kanë përmendur dijetarët dhe mendimtarët, janë:

- Mosnjohja e vërtetë e fesë.
- Sipërfaqësia në të kuptuarit e teksteve pa u thelluar fare në njohjen e qëllimeve të tyre, shkaqeve të tyre dhe urtësive që fshihen pas tyre.
- Preokupimi me çështje sekondare dhe anashkalimi i çështjeve primare dhe madhore.
- Papërmbajtja për ndalimin e gjërave pa argumente dhe përpjekja për të gjetur gabimet e dijetarëve dhe mendimtarëve. Një gjë e tillë sigurisht që është kundër traditës së të parëve tanë, të cilët nuk i thoshin “Haram” asgjëje përveç asaj që me tekst të prerë është e tillë.
- Pasimi i teksteve të paqarta dhe anashkalimi i teksteve të qarta.
- Mosedukimi dhe mosshkollimi pranë dijetarëve të dëshmuar.
- Miopizmi dhe injoranca në raport me aktualitetin, jetën, historinë dhe ligjet kozmologjike.

Disfata shpirtërore që mbizotëroi mbi shpirtrat dhe zemrat e myslimanëve, fatkeqësia ideore që ka kapluar myslimanët, prapambetja ekonomike dhe varfëria që përjetojnë myslimanët,

ndarja në grupe, parti dhe përçarjet e tjera politike, degradimi moral që sot përjetojnë shoqëritë perëndimore dhe islame, - janë si parapërgatitje për shfaqjen e një grupi ekstremistësh nga radhët e të rinjve myslimanë, të cilët predikojnë kthimin e krenarisë islame dhe pozitës së myslimanëve nëpërmjet forcës ose “*Ngritjes së flamurit të xhihadit*” kundër liderëve myslimanë, me anë kryengritjesh kundër tyre për ndërrimin e tyre me liderë që do ta jetësonin këtë dëshirë të tyre...Ky është motivi dhe shkasi kryesor që shtyn këtë grup të rinjsh të ndërmarrin akte të dhunshme dhe kriminale duke vrarë njerëz të pafajshëm, duke shkatërruar institucione publike, duke hedhur në ajër ndërtesa e ura, duke vrarë forcat e rendit e të sigurisë, duke mbytur ata që janë nën sigurinë e shteteve islame (dhimmijj-unët), duke përhapur frikë dhe duke shkaktuar panik tek qytetarët e bashkatdhetarët e tyre...Por, a thua, vallë a arsyeton qëllimi i mirë mjetin e gabuar?! Këta të rinj e kanë gabuar rrugën..., ngase me këto sjellje të pamatura i kanë sjellë Islamit më shumë të këqija e probleme sesa të mira e qetësi.

Disa mendimtarë mendojnë se problemi qëndron në keqkuptimin e Xhihadit, keqkuptimin e pozitës së jomyslimanëve, keqkuptimin e marrëdhënieve me jomyslimanët që jetojnë në shtetin islam, keqkuptimin e ndërrimit të së keqes me forcë, dhe keqkuptimin e ngritjes dhe kundërshtimit të liderëve...

**Terrorizmi
ndërmjet aktualitetit dhe shpresës
(Shërimi i kësaj sëmundjeje)**

Përpyjekjet e diplomatëve dhe politikanëve për shuarjen e zjarrit të dukurisë së terrorizmit

Në tërë botën janë mbajtur me dhjetëra seminare, takime dhe tubime si dhe për studime, hulumtime, punime dhe nisma shkencore janë shpenzuar me miliona dollarë - për të hulumtuar gjurmët, shkaqet dhe motivet e terrorizmit, për të vazhduar më pas me mënyrën e shërimit të kësaj dukurie negative dhe shkatërruese të njerëzimit.

Pas një përpjekjeje të madhe dhe një studimi shkencor sistematik, kanë arritur në disa rezultate, zgjidhje, rekomandime dhe propozime për ballafaqimin me këtë dukuri dhe për çrrënjosjen e saj. Sipas asaj që ka përmendur një oficer i inteligjencës shtetërore për Lindjen e Mesme, këto rekomandime dhe fusha mund t'i përmbledhim në fushat vijuese:

- rrugët diplomatike,
- ligjet penale,
- mjete e vëzhgimit financiar,
- forca ushtarake,
- informacionet (sekrete).

Të gjitha këto mjete duhet të funksionojnë të sistemuara në këshilla nën udhëheqje të ministrive. Këta mendojnë se shprehja “Luftim i terrorizmit“ përfshin përpjekjet e shumta të shumë or-

ganizatave dhe agjencive shtetërore. Lufta kundër terrorizmit përfshin anën diplomatike, e cila synon bashkërendimin e përpjekjeve të huaja shtetërore rreth kësaj çështjeje...sikur që përfshin edhe procedurat financiare të organizatave për ndalimin e pasurimit dhe furnizimit të terroristëve. Ndonjëherë, lufta kundër terrorizmit d.t.th. edhe përdorim i fuqisë së armatosur...

Të ngjashme me këto zgjidhje e rekomandime të përmendura, ishin edhe bazat e bashkëpunimit arab për luftë të përbashkët kundër terrorizmit, dhe kjo në disa fusha:

Në fushën e sigurisë, përveç të tjerash, përmendën marrëveshjen për pengimin e krimeve terroriste duke mos ua mundësuar zhvillimin e pasurive të tyre, duke arritur shpërbërjen e organizimeve për akte terroriste, etj. Prej pikave të marrëveshjes së luftës kundër terrorizmit ishin edhe:

- Arrestimi i terroristëve dhe gjyrimi i tyre sipas ligjit kombëtar,
- Siguria e madhe për personelin e fushës së drejtësisë kundër krimeve,
- Siguri të madhe për burimet e informacioneve për krimet terroriste,
- Ndihma për viktimat e terrorizmit,
- Bashkëpunim ndërmjet organeve të shtetit dhe qytetarëve për luftë të përbashkët kundër kësaj dukurie, dhe

- Nxitje për paraqitjen e rasteve (e veprimeve) terroriste në qendrat zyrtare të shtetit, polici, apo qofshin ato shërbime të tjera...

Edhe pse kam shumë respekt për këto përpjekje shtetërore që janë derdhur, megjithatë ato disi janë të zbehura për shkak se ata u interesuan ta shëronin problemin nga jashtë e jo edhe në brendësinë e tij, prej të cilit burojnë edhe vetë këto ide dhe qasje ekstremiste. Më konkretisht, ata anashkaluan zgjidhjen fetare ose ideore a kulturore për këtë dukuri. Arsyeja e anashkalimit të këtij elementi qenësor fshihet në faktin se perceptimi i këtyre zgjidhjeve, edhe pse i kryer sipas frymës perëndimore, është bërë në mënyrë të përgjithshme duke përfshirë këtu edhe myslimanët, të cilët mund të japin zgjidhje a opsione të tjera për shërimin e kësaj dukurie. Duke pasur parasysh dallimet fetare, zakonet, traditat dhe rrethanat shoqërore, - rekomandimet dhe opcionet e ofruara më parë, ndoshta janë të vlefshme për vendet perëndimore, por mund të jenë tërësisht të pavlefshme për vendet islame apo arabe. Se sa kanë funksionuar këto zgjidhje dhe opsione, shihet shumë qartë në rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të terrorizmit në botë, që, me fjalë të tjera, do të thoshim se nuk kanë shënuar asfarë rezultatesh.

Rezultati i angazhimeve dhe përpjekjeve të derdhura

Nga ajo që shohim sot në botë e që vërteton qartë praninë edhe më të madhe të kësaj dukurie në të gjitha shoqëritë botërore, themi se këto përpjekje nuk ia kanë arritur qëllimit të tyre kundër kësaj dukurie. I tërë problemi-dështimi përqendrohet në mbështetjen vetëm tek faktori njeri dhe ligjet e vëna prej tij si dhe në anashkalimin e faktorit fetar dhe udhëzimit hyjnor, për shërimin e kësaj sëmundjeje, ngase Allahu e di më së miri se ç'i nevojitet njerëzimit. Thotë Allahu:

***“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë“.*²⁶**

Pra, as fetarisht, po as racionalisht, nuk mund të imagjinohet një shërim i vetëm botëror për të gjitha vendet dhe për të gjithë njerëzit. Mentaliteti i një të riu amerikan ose evropian dallon nga mentaliteti i një të riu arab, e kështu me radhë.

²⁶ el-Mulk, 14.

- III-

Alternativa islame është ilaçi i vetëm i propozuar për zhdukjen e kësaj dukurie

Alternativa islame e përmbledhur në “Mesatarinë dhe ekuilibrin në besimin, adhurimet, marrëdhëniet, mendimet dhe çështjet tona, si dhe në largimin nga ekstremizmi, dhuna dhe agresiviteti me të gjitha format dhe mënyrat” - është bari shërues që i ofrojmë ne rinisë sonë dhe institucioneve tona.

Mesatarja në Kur'anin Fisnik

Islami është fe e cila balancën dhe ekuilibrin e kërkon në të gjitha çështjet fetare e të jetës së përditshme. Islami, sa kohë që urdhëron për adhurimin e singertë për Allahun, në njërën anë, ai, në anën tjetër, urdhëron që vetes sonë, fëmijëve dhe familjeve tona, shoqërisë dhe rrethit ku jetojmë, t’u kushtojmë kohë dhe rëndësi. Po kështu, jemi të urdhëruar që edhe botën e përtejme, Ahiretin, të mos e harrojmë, ashtu sikur nuk e harrojmë fatin tonë prej kësaj bote. Allahu, po ashtu, nëpërmjet gjuhës së të dërguarit të Tij, ndaloi nga vetmia për adhurim dhe largimi nga martesë e xhihadi. Le ta shikojmë së bashku këtë ajet uranor, se si Allahu qortoi dhe ndaloi ithtarët e librit, të krishterët dhe çifutët, nga kjo dukuri fetare e dhunshme, pra nga dukuria e ekstremizmit e u tha:

***“O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për All-llahun, përveç asaj që është e vërtetë. Meshu, Isai, biri i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i All-llahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes, dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojeni pra All-llahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: "Tre" (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. All-llahu është vetëm një All-llah; larg qoftë që Ai të ketë fëmijë. Ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë, është vetëm e Tij. Mjafton që All-llahu është planifikues i pavarur“.*²⁷**

Derisa çifutët në librat e tyre të shenjtë kanë fshirë pothuajse tërë aspektin shpirtëror, botës së pastajme nuk i kanë lënë vend, premtimet dhe kërcënimet i kanë përkufizuar vetëm në këtë botë, - të krishterët në Ungjill kanë bërë një ftesë të madhe për eliminimin dhe zhdukjen e vlerës së kësaj dynjaje.

Të kthehemi tek Kur’ani dhe të shohim se çka synohet me “Mesatari”? Cilat janë botëkuptimet dhe aludimet e kësaj shprehjeje?

Thotë Allahu:

***“A doni ta pyetni Të dërguarin tuaj sikurse u pyet më parë Musai. Ai që e ndërron besimin me mosbesim, ai tanimë e ka humbur rrugën e drejtë“.*²⁸**

²⁷ en-Nisa, 171.

²⁸ el-Bekare, 108.

“Thuaj: "A t'ju lajmëroj për një të keqe (të zezë) më të dëmshme (nga ajo e metë që na e shihni) si dënim nga All-llahu? (Ajo është) Mallkimi i atij që e mallkoi All-llahu, dhe hidhërimi ndaj tij, që disa prej tyre i shndërroi në majmunë e në derra, e i bëri adhurues të djallit. Të tillët janë në pozitë më të keqe dhe më të humburit prej rrugës së drejtë“.²⁹

“O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që ju erdhi juve. Ata e dëbojnë të dërguarin dhe ju, sepse i besoni All-llahut, Zotit tuaj, e ju fshehurazi u ofroni miqësi, po Unë më së miri e di atë që keni fshehur dhe atë që keni publikuar. Ai që punon ashtu nga pala juaj, ai e ka humbur rrugën e drejtë“.³⁰

Mufessirët e Kur'anit, si Imam Taberiu, Imam Kurtubiu, Imam Ibni Kethiri, e të tjerë, në komentimet e këtyre ajeteve, respektivisht të *“Rrugës së drejtë“*, në ajetin e parë dhe komenteve të përgjithshme në ajetet vijuese, kanë thënë: *“Rruga më e qëlluar“*; *“humbje nga rruga e vërtetë“*; *“humbje e rrugës së Muhammedit, alejhi's selam“*; *“dalje nga rruga e së drejtës dhe devijimi e lajthitja në rrugë të mashtrimit dhe humbjes“*.

²⁹ el-Maide, 60.

³⁰ el-Mumteherine, 1.

Ajo që përfitojmë nga ajetet uranore, është se ilaçi i propozuar për këtë sëmundje është “Mesataria dhe largimi nga dukuria e ekstremizmit dhe radikalizmit fetar”.

Kur’ani na fton që t’i përmbahemi këtij parimi duke na rikujtuar se ne, pikërisht në bazë të këtij parimi, u shquam si populli më i mirë i dalë në sipërfaqe të tokës. Ne si popull mesatar, popull i balancuar, me urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, si dhe me besimin tek Allahun Një, merituar një epitete të tillë. Islami është fe e maturisë, tolerancës, dhe siç thotë Allahu:

“Dhe ashtu (siç ju udhëzoam në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush...”.³¹

Islam bën thirrje për mesatari dhe maturi edhe për shpenzime për të tjerët. Për ta ruajtur këtë parim, Islami ne nuk na lejon që pasurinë tonë ta shpenzojmë e ta harxhojmë ashtu siç të na teket neve. Thotë Allahu:

“Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrënguar, por mbajnë mesataren e janë të matur”.³²

Mesatarja ishte metodologji profetike, të cilën e ushtronin profetët edhe në adhurimin e tyre për Allahun. Ata jetonin në mes frikës për ndëshkim dhe shpresës për falje. Thotë Allahu:

³¹ el-Bekare, 143.

³² el-Furkan, 67.

“...Ata përpiqeshin për punë të mira, Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh”.³³

Nëse studiojmë tekstet profetike dhe biografinë e Muhamedit, alejhi's selam, do të shohim se ai ishte një predikues i madh i këtij programi hyjnor, madje edhe nga vetë praktika e tij reflektonte një ftesë e tillë. Ai, alejhi's selami, hante po edhe agjëronte, martohej, e adhuronte Allahun po edhe pushonte, vizitonte fqinjët e tij, çifutë e të krishterë, kishte raporte edhe me hipokritët nga radhët e myslimanëve...Bazuar në këto, myslimani duhet të gjejë mesataren ndërmjet konservatorëve dhe modernistëve, politikanëve myslimanë me edukatë islame dhe atyre që mohojnë tërësisht politikën me pretekst të angazhimit vetëm për edukim dhe vetëdijësim të myslimanëve, duke mos ditur asgjë për gjërat rreth tyre dhe gjërat që e kërcënojnë Islamin, mesatar ndërmjet atyre që thithin kulturën perëndimore pa asnjë kusht, dhe në mes atyre që mohojnë atë me çdo kusht, e kështu me radhë.

Mesatarja në traditën profetike

Shprehjet e Muhamedit, alejhi's selam, dhe dijetarëve nga gjeneratat e para për nevojën për t'iu përmbajtur këtij parimi, pra mesatares, janë të shumta e të ndryshme. Gjatë hulumtimit

³³ el-Enbija, 90.

tonë që u bëmë teksteve profetike, pamë se në mesin e shumë shprehjeve me të cilat shprehet një parim i tillë, janë edhe këto:

“Kërkoni me veprat tuaja të drejtën (dhe përmbyllni ato me të mira si) dhe gjejeni mesataren (në të gjitha çështjet, e ikni nga ekstremizmi)”³⁴,

*“Askush nuk do të mundohet ta sfidojë këtë fe (të ngarkojë veten prej kësaj feje me atë që nuk mundet) e që nuk do të dësh-
tojë”,³⁵*

“Unë agjëroj, po edhe ka ditë që pushoj e nuk agjëroj”.³⁶

Ndërsa prej shprehjeve të dijetarëve të gjeneratës sonë të pa-
rë, do të veçonim:

“Nuk ka tejkallim kufijsh (të normales) por as lëshime”;

“Mesatari në adhurim”;

“Largimi i së keqes nga ky ymet”, etj.

Muhamedi, alejhi’s selam, sikur që përmendi të mirat nëse i përmbahemi këtij parimi, ai po ashtu paralajmëroi edhe rreziqet e ekstremizmit, radikalizmit dhe përfundimin-rezultatit e keq të tyre. Prej këtyre, do të përmendim:

- Shkatërrimi i ekstremistëve. Muhammedi, alejhi’s selam, ka thënë tri herë:

“Janë shkatërruar ata që në fjalët dhe veprat e tyre kalojnë kufijtë e normales”.

³⁴ Transmeton Buhariu ndërsa përkthimi i hadithit është bërë bazuar në Tuhfetu’l ahvedhijj, komentit e Sunenit të Tirmidhiut, hadithi nr.: 2067.

³⁵ Transmeton Buhariu. Në koment të këtij hadithi të shënuar te Sherhu suneni’n Nesaijj, hadithi nr.:4948, në mes tjerash qëndron: Në veprat tuaja ndiqeni mesataren e as mos bëni lëshime por as mos kaloni në ekstravagancë. Përkthyesi.

³⁶ Buhariu.

- Rreziku nga monotonia në adhurim. Buhariu transmeton në Sahihun e tij tregimin e Zejnebes, se ajo kishte lidhur një litar në xhami në mes dy shtyllave. Kur hyri Muhamedi, alejhi's selam, dhe e pa, tha: *“Ç’është ky litar? Është litari i Zejnebes. Kur kotet, ajo mbahet për këtë litar që të mos flejë dhe të vazhdojë adhurimin-sqaruan ata që ishin në xhami. Jo, kjo është gabim, zgjidheni këtë litar. Faluni aq sa e ndieni veten të çlodhur dhe të pushuar e, kur t’ju flihet, pushoni-flini- tha Muhammedi, alejhi's selam”*.

- Mesatarja edhe në çështjet personale, siç transmetohet në hadithin: *”... Sa më përket mua, pasha All-llahun, unë jam më i drojtur dhe më i devotshëm ndaj All-llahut sesa ju, por unë agjëroj dhe ha, falem dhe fle, dhe bëj jetë bashkëshortore! Kush largohet nga Syneti im, ai nuk më përket mua”*.³⁷

- Mesatarja në marrëdhëniet shoqërore. Imam Bejhekiu përmend se Hasani ka thënë: *“Doni me maturi dhe urreni me maturi, ngase disa njerëz tejkaluan kufijtë në dashuri e u shkatërruan, sikurse u shkatërruan të tjerët që kaluan normalen në urrejtjen e tyre. Pra, bëhu mestar - i matur edhe në dashuri, po edhe në urrejtje”*.

Nga tekstet e lartpërmendura, përfundojmë se, nëse e duam shpëtimin dhe sigurinë në këtë botë dhe në botën tjetër, patjetër dhe në mënyrë të prerë duhet t’i përmbahemi parimit të mesata-

³⁷ Transmetim unanim.

risë në jetën tonë fetare, shoqërore dhe personale. Ky është urdhër i prerë dhe obligim individual (farz ajn).

-IV-

Disa rrugë dhe metoda të suksesshme për shërimin e dukurisë së terrorizmit

Analistët kanë arritur në përfundimin se dukuritë shoqërore që nuk shërohen apo trajtohen në rrënjët e tyre dhe as luftohen shkaqet e shfaqjes se tyre, rishfaqen përsëri. Terrorizmi nuk mund të zhduket derisa të mos zhduken shkaqet e tij të vërteta dhe rrënjët e tij ideore. Ne nuk do të mund ta zhdukim dukurinë e dhunës dhe terrorizmit përderisa të mos zhytemi në beteja ideologjike dhe kulturore me këta njerëz, ngase kultura është ajo që nën vellon e fesë u lejon dhe sikur arsyeton vrasjet që bëjnë. Në vijim, do të përmendim rrugët më të rëndësishme që ndihmojnë në çrrënjosjen e kësaj dukurie të egër shoqërore:

- Patjetër duhet bërë riformulimi-rihartimi i botëkuptimeve fetare në shoqëritë arabe dhe islame. Parimet fetare duhet të zhvishen nga çdo element i dhunës, ekstremizmit dhe urrejtjes.
- Përforcimi i parimeve të dialogut, tolerancës dhe pranimit të tjetrit, qoftë me të menduar, qoftë edhe me qenien e tij.

- Siguria shoqërore nuk mund të garantohet përderisa të mos garantohet edhe siguria dhe ruajtja e së drejtës së të menduarit, të dijes, lirisë dhe barazisë.
- Terrorizmi është pjellë e lëshimeve të mëdha në çështjet ekonomike dhe shoqërore, si dhe e dhunës, prandaj duhet realizuar një drejtësi për të gjitha shtresat e shoqërive tona.
- Dallimet në mendime, ide dhe medh'hebe nuk shkaktojnë edhe ndarjen nga kolektivi dhe jetesa e përbashkët.
- Islami na urdhëron që individët dhe shoqërinë t'i pastrojmë nga urrejtja e cila buron nga zilia dhe shpirtvrazhdësia, dhe të gjithë, të bashkuar, të qëndrojmë stoikë përballë çdo shtrëngate që fryn nga kulturat që ushqejnë dhe rrisin urrejtjen, zilinë, mërinë dhe përçarjen ideore apo fetare.
- Mjetet e informacionit (mediat) duhet të tregojnë dhe të shfaqin një transparencë të ekspeditave perëndimore karshi plan-programeve fetare në shoqëritë tona islame, në mënyrë që kjo të mos bëhet shkak që këta të rinj, si kundërreagim, të kryejnë gjëra-vepra të tilla.
- Një trajtim mjekësor dhe psikologjik i madh u duhet bërë atyre luftëtarëve që janë kthyer nga vatra të luftës. Ata atje janë ushqyer me idetë se xhihadi është bazë e jetës, kurse paqja është përjashtim nga rregulli, dhe se jeta pa xhihad humb domethënien e saj.
- Nuk duhet të mos përfillim rolin negativ që luajnë disa teatro, kinema dhe klube të natës në vendet dhe shoqëritë islame.

Disa hotele janë të njohura për punët e ndyta që ushtrojnë, dhe në mënyrë a në një tjetër, bëhen shkak që të jenë caqe të sulmeve të të rinjve myslimanë, të cilët nuk mund ta përmbajnë veten para dukurive të tilla. Që të mos i fryjmë zjarrit me shumë, duhen penguar zhvillimi dhe ushtrimi i lirë i veprimeve të tilla famëkeqe në hotelet tona.

- Dukuritë negative që janë shfaqur në shoqëritë tona, si: papunësia, kamata, ngritja e çmimeve, kushtet e rënda për jetesë, ndihmat e ulëta sociale, varfëria e skajshme etj., shpeshherë bëhen shkaqe që viktimat e tyre të ngrihen kundër dhe të shkaktojnë trazira e rrëmuja në vend. Andaj, për të mos ndodhur më e keqja, duhet të krijohen kushte më të mira për jetesë, të ofrohen mundësi punësimi, shkollimi, shërimi, etj.
- Duhet luftuar racizmi në të gjitha format dhe ngjyrat e tij. Njerëzit duhen pajtuar duke flakur mosmarrëveshjet në marrëshëniet prind-fëmijë, burrë-grua, vëlla-vëlla, etj.
- Rregull bazë për këtë mbetet se zjarri me zjarr nuk shuhet, dhuna me dhunë nuk ndalet, kështu që mbetet shërimi i mendimit me mendim, i idesë me ide, çfarëdo që të jetë ajo; e devijuar apo e pabazë.

*“Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente”.*³⁸ Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

³⁸ Kaf, 37.

LITERATURA NE GJUHEN ARABE

- أسامة إبراهيم حافظ؛ عاصم عبد الماجد محمد: **مبادرة وقف العنف – رؤية واقعية ونظرة شرعية**، أقره و راجعه: كرم محمد زهدي-علي محمد علي الشريف – ناجح إبراهيم عبد الله – محمد عصام الدين درباله – فؤاد محمود الدواليبي – حمدي عبد الرحمن عبد العظيم، مكتبة العبيكان، ط1-2004، الرياض – المملكة العربية السعودية.
- -----: **تسليط الأضواء على ما وقع في الجهاد من من أخطاء**، أقره و راجعه: كرم محمد زهدي-علي محمد علي الشريف – ناجح إبراهيم عبد الله – محمد عصام الدين درباله – فؤاد محمود الدواليبي – حمدي عبد الرحمن عبد العظيم، مكتبة العبيكان، ط1-2004، الرياض – المملكة العربية السعودية.
- -----: **حرمة الغلو في الدين و تكفير المسلمين**. مكتبة العبيكان، ط1-2004، الرياض – المملكة العربية السعودية.
- أمل يازجي & محمد عزيز شكري: **الإرهاب الدولي و النظام العالمي الراهن**، دار الفكر، دمشق – سوريا، ط1، 2002.
- أبو سليمان، عبد الحميد: **أزمة العقل المسلم**، من مطبوعات المعهد العالمي للفكر الإسلامي، 1996، كوالا لمبور – ماليزيا.
- أبو العباس، أحمد بن عبد الحليم بن تيمية الحارثي: **مجموع الفتاوى – باب الوصية الكبرى**، المملكة العربية السعودية – الرياض، 1400 هـ
- أبو فرحة، جمال الحسيني: **الخروج على الحاكم في الفكر السياسي الإسلامي**، ط1-القاهرة – 2004 ، مركز الحضارة العربية
- فتاح، عرفان عبد الحميد: **محاضرات عن قضايا أساسية في أديان العالم – Lectures on Major Themes in World Religions** ، من مطبوعات الجامعة الإسلامية العالمية بكوالا لامبور – ماليزيا، 2000.

- فتاح، عرفان عبد الحميد: اليهودية - عرض تاريخي - والحركات الحديثة في اليهودية، دار عمار، ط1، 2002، عمان - الاردن
- يحيى عبد المبدى، معهد الدراسات الإفريقية - جامعة القاهرة، 25.11.2004 (مفهوم الإرهاب بين الأصل و التطبيق) في موقع على الإنترنت: <http://www.google.com>
- ياغي، إسماعيل أحمد: الإرهاب و العنف في الفكر الصهيوني، مكتبة العبيكان، ط1، 2003، الرياض - المملكة العربية السعودية.
- السحمراني، أسعد: لا للإرهاب نعم للجهاد، دار النفائس، ط1، 2003، بيروت - لبنان، خليل، إبراهيم: تشريح الإسرائيلي - رؤية توراتية لجسد إسرائيلي، مكتبة التراث الإسلامي، القاهرة - 1997.
- سانو، قطب مصطفى، الإرهاب بين الشريعة الإسلامية و أف بي آي FBI، محاضرة علمية ألقاها في الندوة الأسبوعية في الجامعة الإسلامية العالمية في كوالالمبور بماليزيا، بتاريخ 15.09.2003
- قطب، سيد: لماذا أعدموني، من مطبوعات الشرق الأوسط للإعلام، ط1، 1990، القاهرة.
- قطب سيد: في ظلال القرآن، دار الشروق، ط5، 1994، القاهرة
- عبد الله، ناجح إبراهيم: تفجيرات الرياض - الأحكام و الآثار، الناشر: مكتبة التراث الإسلامي، 1425/7/15 هـ، قراءة للكتاب: عماد الخطيب، في موقع على الإنترنت: <http://www.islamonline.net>
- الأشقر، عمر سليمان عبد الله: نحو ثقافة إسلامية أصيلة، دار النفائس للنشر و التوزيع، عمان، ط12، 2002
- النيسابوري: مسلم بن الحجاج أبو الحسين القشيري: صحيح مسلم دار إحياء التراث العربي - بيروت، تحقيق: محمد فؤاد عبد الباقي
- القرضاوي، يوسف: المسلمون و العنف السياسي - نظرات تأصيلية، 6.06.2004، في موقع على الإنترنت: <http://www.alqaradawi.net>

- القرضاوي، يوسف: **الصحوة الإسلامية بين الجحود و التطرف**، مكتبة وهبة، 1412، بيروت، لبنان.
- القرضاوي، يوسف: **الخصائص العامة للإسلام**، مؤسسة الرسالة، ط1997، 10، بيروت، لبنان.
- السحمراني، أسعد: **لا للإرهاب نعم للجهاد**، دار النفائس، ط2003، 1، بيروت
- بول آر. بيلار، **سبل مكافحة الإرهاب**، ضابط الاستخبارات القومية للشرق الأدنى و جنوب آسيا في المجلس القومي للاستخبارات - وكالة الاستخبارات المركزية.
- الغنوشي، راشد: **ضرورة المراجعة الذاتية في ضوء القرآن و الحرية الدينية**، في إحدى محاضراته العلمية، حينما زار الجامعة الإسلامية العالمية في ماليزيا عام 2002م.
- ديوك، ديفيد: ترجمة: سعد رستم: **أمريكا - إسرائيل و 11 أيلول 2001**، الأوائل للنشر و التوزيع 2002، ط1، دمشق-سوريا.
- النووي، أبو زكريا يحيى بن شرف: **آداب الفتوى**، دار الفكر - دمشق، ط1، 1408، تحقيق: بسام عبد الوهاب الجنابي.
- ضميرية، عثمان جمعة: **مدخل لدراسة العقيدة الإسلامية**، مكتبة السوادي للتوزيع، جدة، ط4، 2003،
- الغفيلي، فهد بن عبد العزيز: **حوار مع الإرهاب**، ط1، 1425، الرياض
- البوطي، محمد سعيد رمضان **نحو منهج تربوي فريد**، دار الفكر، ط2، دمشق - سوريا، 1988.
- أبو عبد الله، محمد بن أحمد بن أبي بكر بن فرح القرطبي: **الجامع لأحكام القرآن**، دار الشعب - القاهرة، ط2، 1372، تحقيق: أحمد عبد العليم البردوني.
- أبو جعفر، محمد بن جرير بن يزيد بن خالد الطبري: **جامع البيان في تأويل آي القرآن**، دار الفكر، بيروت، 1405.
- الجعفي: محمد بن اسماعيل أبو عبد الله البخاري: **صحيح البخاري**، دار ابن كثير، اليمامة، بيروت، ط3، 1407، تحقيق: د. مصطفى ديب البغا.
- الهيثمي، علي بن أبي بكر: **مجمع الزوائد و منبع الفوائد**، دار الكتاب العربي - بيروت.

- السجستاني، سليمان بن الأشعث أبو داود: سنن أبي داود، دار الفكر، تحقيق: محمد محي الدين عبد الحميد.
- البستي، محمد بن حبان بن أحمد أو حاتم التميمي: صحيح ابن حبان، مؤسسة الرسالة- بيروت، 1414، ط2، تحقيق الشيخ: شعيب الأرناؤوط.
- البيهقي، أبو بكر أحمد بن الحسين: شعب الإيمان، دار الكتب العلمية-بيروت، 1410، ط1، تحقيق: محمد السعيد بسيوي زغلول.
- المروزي، محمد بن نصر بن الحجاج أبو عبد الله: كتاب السنة، مؤسسة الكتب الثقافية-بيروت، 1408، ط1، تحقيق: سالم أحمد السلفي.
- يالجن، مقداد: طريق السعادة، ط1، 1987، مطابع البكيرية، الرياض.
- أبو الفداء، إسماعيل بن عمر بن كثير المشقي: تفسير القرآن العظيم، دار الفكر، بيروت، 1401.
- المحلي، محمد بن عبد الرحمن بن أبي بكر، و السيوطي: عبد الرحمن: تفسير الجلالين دار الحديث-القاهرة ط1.
- ظاهرة العنف الديني.. لماذا؟!، المركز العالمي للاستشارات الاستراتيجية، ط2، 2004، مكتبة العبيكان، الرياض، المملكة العربية السعودية.
- مهلاً هنتغتون.. مهلاً فوكوياما - نظرية الشبكة التصفوية في صراع الثقافات و المادة، اعداد: المركز العالمي للاستشارات الاستراتيجية، ط2، 2004، مكتبة العبيكان، الرياض - المملكة العربية السعودية.
- الكواكبي، عبد الرحمن: طبائع الاستبداد و مصارع الاستعباد - تقديم و دراسة: د. أسعد السحمراني، دار النفائس، بيروت- لبنان، ط2، 2003.
- يالجن، مقداد: الرحلات العلمية من الشرق إلى الغرب- رحلة د. مقداد يالجن - الحاصل على جائزة الملك فيصل العالمية. دار عالم الكتب-الرياض، ط1-1992.
-الطريق إلى العبقريّة، دار الهدى للتوزيع و النشر، الرياض، ط1، 1987.

- **الوجيز في إسلامية المعرفة**، المعهد العالمي للفكر الإسلامي، 1987 هيرندن، فيرجينيا، الولايات المتحدة الأمريكية.
- **العسال، أحمد محمد: الإسلام و بناء المجتمع**، ط5، ، دار القلم، الكويت، 1982.
- **الربيعه، عبد العزيز عبد الرحمن: صور من سماحة الإسلام**، ط4، 2001، الرياض.
- **الحقيل، سليمان بن عبد الرحمن: حقوق الإنسان في الإسلام و تطبيقاتها في المملكة العربية السعودية**، ط1، 2000.
- **الطلاع، رضوان بن طاهر: نحو أمن فكري إسلامي**، ط2، 1420، الرياض.
- **سلطان، جمال: جهادنا الثقافي - مواقف و إشارات، مركز الدراسات الإسلامية، برمنجهام - بريطانيا، ط1، 1993.**
- **عبد الحميد، محسن: أزمة المثقفين تجاه الإسلام في العصر الحديث**، ، دار الصحوة للنشر و التوزيع، ط1، 1984
- **علوان، عبد الله ناصح: الشباب المسلم في مواجهة التحديات**، دار القلم، دمشق، ط4، 2002
- **بكار، عبد الكريم: عصرنا والعيش في زمانه الصعب**، دار القلم، دمشق، ط2، 2004.
- **الدريوش، أحمد بن يوسف بن أحمد: طاعة ولي الأمر و أثرها في تحقيق أمن الوطن - دراسة شرعية**، ط1، 2005، دار كنوز إشبيليا للنشر و التوزيع - الرياض
- **الياسين، لواء عبد الرحمن أبكر: الإرهاب سرطان المجتمعات المعاصرة**، ط1، 2003، دار طويق للنشر و التوزيع، الرياض، المملكة العربية السعودية
- **الموجان، أحمد بن حسين بن عبد الله: الإرهاب.. روافده.. أسبابه الفكرية... علاجه.. أقوال العلماء فيه**، ط1، 2004، سنا الفاروق للنشر، جدة، المملكة العربية السعودية
- **خليل، إبراهيم: تشريح الإسرائيلي - رؤية توراتية لجسد إسرائيلي، مكتبة التراث الإسلامي، القاهرة - 1997**

- الدوسري، فهد بن مبارك محمد الدوسري: **الغلو في الدين ووسطية الإسلام**، مدار الوطن للنشر و التوزيع، ط1، 2005، الرياض، ص:22-61
- **الموافقات في الشريعة الإسلامية، للإمام الشاطبي**
- النيسابوري، محمد بن عبد الله أبو عبد الله الحاكم: **المستدرک علی الصحیحین**، دار الكتب العلمية، بيروت، 1990، ط1، تحقيق: مصطفى عبد القادر عطا، ج3، ص: 476، الرقم: 5778،
- الحسيني، إبراهيم بن محمد: **البيان و التعريف**، دار الكتاب العربي، بيروت، 1401 هـ، تحقيق: سيف الدين الكاتب، ج2، ص:247
- ديوك، ديفيد: ترجمة: سعد رستم: **أمريكا - إسرائيل و 11 أيلول 2001**، الأوائل للنشر و التوزيع 2002، ط1، دمشق-سوريا
- العودة، سلمان بن فهد: **مقولات في فقه الموقف**، ط2، 2002، مؤسسة الجريسي للتوزيع، الرياض.
- الغنامي، خالد: **استراتيجية مكافحة الإرهاب**..مقال على الانترنت، يبحث بهذا العنوان في:
<http://google.com>